



Nr. Prot. 326

14.02.2023

Qendra Rajonale Pejë

dhe

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë

lidhin

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike është Institucioni më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor i Kosovës, organizon, zhvillon, mbikëqyrë dhe zbaton politikat e shëndetësisë publike në Kosovë.

IKSHPK mbulon gjithë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet degëve të veta – Instituteve të Shëndetësisë Publike (ISHP) të organizuara në këto Qendra rajonale: Pejë, Prizren, Mitrovicë, Është Institucion Shëndetësor që planifikon, programon dhe vlerëson politikat shëndetësore, përgatit dhe zbaton strategjinë e shëndetit publik (Masat higjieniko – sanitare, masat profilaktiko – kunderepidemike, socialo mjekësore, promovimin e shëndetit, edukimin dhe arsimimin shëndetësor, kontrollin e kualitetit të ujit dhe ushqimit, PZI (programi i zgjëruar i imunizimit), politikën shëndetësore dhe ekonomiken shëndetësore, informimin shëndetësorë) në mbarë territorin e Kosovës.

Palët:

1. UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA" NË PEJË, të cilën e përfaqëson Prof.Dr. Armand Krasniqi – Rektor; dhe
2. INSTITUTIT KOMBËTAR TË SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS – Qendra Rajonale në Pejë, të cilin e përfaqëson Dr. Adnora Nurboja – Drejtoreshë

Për

Ofrimin e ligjërata promovuese dhe vetdijësuese në kuadër të programeve dhe aktiviteteve të planifikuara të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës me fokus të veçantë për studentë dhe personalin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së shëndetit publik.

Qëllimi i lidhjes së memorandumit

Qëllimi i këtij memorandumi ekskluzivisht është i bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ndjen dhe që ka Universiteti "Haxhi Zeka" (ne tekstin e mëtejme UHZ) në fushën e ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit të studentëve dhe personalit të saj në përgjithësi e në veçanti në ambientet e këtij institucioni dhe në detyrimet dhe funksionin programor që ka Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë.

Ekziston një lidhje e pandashme ndërmjet termit 'edukimi shëndetësor' dhe 'promovimi shëndetësor'. Promovimi i shëndetit është përhapja e edukimit të shëndetit me ndihmën e institucioneve edukativo-arsimore dhe të ambientit jetësor në përgjithësi.

Pra, promovimi i shëndetit u mundëson studentëve që ta rrisin kontrollin mbi shëndetin e tyre.

Ky promovimi do të realizohet nëpërmjet Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike – Qendra Rajonale në Pejë (ne tekstin e mëtejme IKShPK – Qendra Pejë) në cilësinë e institucionit me kompetencë profesionale dhe ligjore kombëtare, e që do të realizohet në mjedise Universitetit "Haxhi Zeka"

Fushëveprimi:

Instituti i Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës – Qendra Rajonale në Pejë, në kuadër të programit të vet, do ndërmarr aktivitete të planifikuara e ta caktuara promovuese në këto fusha:

- ▶ Promovimin e shëndetit;
- ▶ Promovimin e masave për parandalimin e sëmundjeve;
- ▶ Shpërndarje të informatave dhe materialit për këto qëllime;
- ▶ Këshillime për trajtimin e të sëmurëve
- ▶ Këshillime për rehabilitimin.

Në kuadër të këtij fushëveprimi dhe mbi bazën e planit të punës, të programit për edukim, promovim dhe aktiviteteve tjera që ka Instituti i Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës – Qendra Rajonale në Pejë, do të angazhohet nëpërmjet organizimit të ligjëratave dhe materialeve promovuese e vetdijësim, në hapësirat e UHZ –së.

Në këtë drejtim do të ndërmarrë këto aktivitete:

- 1) Promovimin i shëndetit që përfshin forcimin e aftësive të studentëve/ individëve për të inkurajuar sjellje të shëndetshme, dhe kjo gjithashtu përfshin ndërtimin e mjediseve të shëndetshme shoqërore dhe fizike për të mbështetur këto sjellje;
- 2) Promovimin i shëndetit në formë të çdo kombinim të edukimit shëndetësor dhe ndërhyrjeve të ngjashme organizative, ekonomike dhe politike të dizajnuara për të lehtësuar ndryshime të sjelljes dhe mjediseve të favorshme për shëndetin;
- 3) Promovimin shëndetësor si një proces për aftësimin e studentëve / individëve për të rritur kontrollin e tyre mbi shëndetin, si dhe për ta përmirësuar atë.

Aktiviteti i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë – Qendra Rajonale në Pejë do të fokusohet edhe për promovimin e aktiviteteve që dalin nga Organizata Botërore e Shëndetësisë që mund të lidhën me:

- 1) Promovimin shëndetësor përfshin popullatën në tërësi,
- 2) Promovimin shëndetësor fokusohet në faktorët përcaktues ose shkaktarët e sëmundjeve;
- 3) Promovimin shëndetësor me këshillime për kombinimin e metodave dhe përqsasjeve të ndryshme, por që gjithsesi plotësojnë njëra- tjetrën,;
- 4) Promovimin shëndetësor me synim kryesor përfshirjen dhe bashkëpunimin konkret dhe të drejtpërdrejtë të popullatës.

Detyrimet e Universitetit “Haxhi Zeka”

1. UHZ do bashkëpunojë ngushtë me *IKShPK – Qendra Pejë*, që të hartojë planin dhe orarin e ligjëratave të cilat *IKSHP – Qendra Pejë* do t’i realizojë në ambientet e UHZ –së;
2. Prorektori për mësim dhe çështje të studentëve do të jetë koordinator i të gjitha aktiviteteve të planifikuara të cilat *IKShPK – Qendra në Pejë* do t’i realizojë në UHZ;
3. UHZ do t’i ofrojë pa asnjë rezervë *IKShPK – Qendra Pejë* të gjitha mjete e nevojshme teknike për të realizuar ligjëratat;
4. UHZ, mbi bazën e planit të punës me *IKShHPK – në*, do t’i sigurojë ambiente e përshtatshme për realizimin e ligjëratave;
5. UHZ do të bashkëpunojë ngushtë me Parlamentin e Studentëve dhe më Këshillat e studentëve në njësi akademike për përfshirje sa më të madhe të studentëve në ligjëratat;
6. UHZ së bashku me Parlamentin e Studentëve dhe Këshillat e studentëve në njësi akademike do të angazhohen për shpërndarjen eventuale të materialeve promovuese të cilat *IKSHP – ja* i konsideron të nevojshme për distribuim;
7. UHZ – ja do të publikojë në web zyrtarë të gjitha materialet dhe informatat e *IKSHP* të cilat vlerësohen me rëndësi për studentë, personalin e UHZ –së dhe popullatës në përgjithësi;

8. UHZ do t'i ndërmarr të gjitha masat dhe veprimet për çdo aktivitet dhe këshillë të cilën IKSHP – ja e vlerëson të rëndësishme që duhet realizuar në kuadër të kësaj fushëveprimtarie;

Cilësitë e veçanta të këtij memorandumi:

Ky memorandum mirëkuptimi në tërësinë e vet shpreh mirëkuptimin e palëve lidhur me temën për çfarë lidhet. Si i tillë, për asnjërin nga palët, nuk ka për qëllim të krijojë detyrime ligjore, të krijojë asnjë të drejtë, privilegje ose përfitim për asnjë person ose palë çfarë do qofshin ato;

Të gjitha ndryshimet të këtij memorandumi ndërmjet palëve të cilat mund të lindin nga interpretimi, ndryshimi apo zbatimi i cilit do aspekt të tij, mund dhe duhet të zgjidhen vetëm me konsultim reciprok e pa referencën ose përfshirjen e asnjë pale të tretë duke e përfshirë edhe gjykatën.

Kohëzgjatje e memorandumit të mirëkuptimit;

Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

Palët janë pajtuar që ky memoradum mirëkuptimi të jetë pa afat dhe në rast se e konsiderojnë të arsyeshme, secila nga ato mund të ndërpres në çdo kohë me një paralajmërim paraprak prej 30 ditësh;

E lidhur me 14. 02.2023

Palët

Për: Universitetin "Haxhi Zeka"
Prof. Dr. Armand Krasniqi – Rektor

Për: Institutin Kombëtar të Shëndetësisë
Publike të Kosovës – Qendra në Pejë:
Dr. Adnora Nurboja – Drejtoreshë